

VENDIM

“PËR CAKTIMIN E MASËS SË SEKUESTROS PREVENTIVE”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR : ARDIAN KALIA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Beglie NURA**, sot më datë **27/05/2014**, mori në shqyrtim materialin procedues që i përket :

KËRKUES: PROKURORIA pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me prokuror **Elio MAZREKU**.

OBJEKTI: Caktimin e masës së sigurimit pasuror “Sekuestro Preventive”.

Baza Ligjore: Nenet 274 të K.Pr.Penale, 36 të Kodit Penal.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, provat e paraqitura nga ana e subjektit kërkues, bazuar në nenet 36 të Kodit Penal, 274 e 276 të K.Pr.Penale,

VËREN

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vënë në lëvizje Gjykatën e këtij rrethi gjyqësor me kërkesën me objekt e shkak ligjor si më lart. Nga përmbajtja e materialeve shkresore bashkangjitur kërkesës për marrje e masës së sigurimit pasuror rezulton e provuar se:

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr.5305, të vitit 2013, për veprat penale “Mashtrimi” të parashikuar nga neni 143/2 i Kodit Penal në ngarkim të shtetasve K.Ç dhe A.Ç. Nga ana e Përfaqësuesit të Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë u parashtrua veç të tjerash sa vijon:

“Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 07.10.2013, ka regjistruar procedimin penal nr. 5305, për vepren penale te parashikuar nga neni 143 te Kodit Penal. Nga hetimet e kryera dhe aktet e administruara ka rezultuar se: Ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimeve të shtetasve K. e A.Ç dhe F.Yndaj njëri-tjetrit për veprime juridike të bëra me akte noteriale. Këta shtetas

kanë patur marrëdhënie juridike financiare me njëri-tjetrin në vitet 2010 dhe 2012. Më datë 30.11.2010, është hartuar një deklaratë noteriale ndërmjet F.Y nga njëra anë dhe K. e A.Ç, për marrjen prej këtyre të fundit të shumës prej 120.000 EUR, dhe më 30.04.2012, për një shumë prej 142.000 EUR, me të njëjtat palë. Për shkak të mospërbushjes së detyrimeve, më datë 12.11.2012 F.Y ka kërkuar lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për deklaratën noteriale datë 30.11.2010. Më datë 25.01.2013 palët kanë arritur një marrëveshje për ekzekutimin e këtij detyrimi. Duke qenë se, ekzekutimi nuk është bërë sipas marrëveshjes të datës 25.01.2013, F.Y është drejtuar sërish, gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për marrëveshjen datë 25.01.13, ku gjykata me vendim datë 30.07.2013 është shprehur, se palët janë para një konflikt civil i cili duhet zgjidhur me themel.

Më datë 22.07.2013 shtetasit K. dhe A.Ç, kanë paraqitur kallëzim ndaj F.Y dhe noteres Baroshe Hoxha, duke pretenduar se, janë mashtruar në deklaratën noteriale datë 12.11.2012, duke paraqitur faktin e rremë, sikur detyrimi prej 142.000 EUR, është një detyrim i lindur rishtazi. Për rrjedhojë, kjo deklaratë nuk paraqet v ullnetin e tyre të vërtetë, por janë mashtruar. Më datë 30.09.2013 shtetasi F.Y ka paraqitur kallëzim ndaj K. dhe A.Ç, pasi pretendon se, të kallëzuarit për marrjen e shumave në total si më sipër, kanë përdorur gënjeshtren, duke ia paraqitur sikur me to do të realizonin investime. Fakt i cili nuk ka ndodhur. Përmes të njëjtit mekanizëm ata kanë mashtruar edhe persona të tjerë. Mbi bazën e kallëzimeve të shtetasve të mësipërm është regjistruar procedimi penal nr.5305, datë 07.10.2013 për veprën penale sipas nenit 143 të Kodit Penal. Shtetasit A.Ç dhe K.Ç kanë në pronësi një shoqëri tregtare “Arbi 06” shpk, me të cilin ushtrojnë aktivitete të ndryshme tregtare.

Pyetur me cilesine e personit qe tregon rrethana objekt hetimi shtetasi F.Y ka sqaruar se me shtetasit A.Ç dhe K.Ç njihet pasi kane qene fqinje, dhe ata merreshin me aktivitet privat ne disa shtete. Ne keto rrethana ka shkuar shume here jashte shtetit se bashku me to, duke i ngjallur besim qe jane tregtare te mirefillte. Ne keto rrethana kur ata i kane kerkuar atij ne vitin 2010 borxh nje shume prej 120 mije euro, ai ja ka dhene ne date 30.11.2010 ku eshte lidhur dhe kontarata perkatese tek notere Baroshe Hoxha, per kete fakt, me afat kthim per 6 muaj, ku do ti ktheheshin ne date 30.05.2011. Pas kesaj perseri keta dy shtetas pa shlyer detyrimin e pare i kane kerkuar atij dhe 142 mije euro, pasi i kane thëne se do te blinin një fabrike letre ne Bosnje, te cilat ja ka dhene shtetasit K.Ç ne dore, formalizuar me akt noterial. Por kjo shume lekesh te dhena nga ana e tij nuk i jane kthyer. Shtetasi T.K njihet me A.Ç dhe K.Ç nga viti 2006, pasi ka patur mardhenie pune me ta deri ne vitin 2011, si pronar i firmes “MGJ

Robin ”shpk, (me aktivitet ne Gostivar, per prodhimin e patatineve) dhe me keta dy shtetas ishte bere nje marrëveshje, kontrate noteriale, ku ishte pasqyruar ne detaje bashkëpunimi mes firmes “Arbi 06” dhe firmes tij “MGJ Robin”. Ky shtetas sqaron se, K. dhe A kane marre tek ai vetem mall (me maune) dhe pagesa (likuidimi i cmimit) behej me ane te bankes. Ne vitin 2008, ku keta dy shtetasve (ne telefon, i kane thene se kishin falimentuar) dhe eshte mbyllur firmene “Arbi 06” dhe shtetasit K. dhe A.Ç (me firmen “Arbi 06”) i mbeten pa likuiduar shumen e 33216 euro, Gjithashtu shtetasi T.K ka sqaruar se, pasi keta dy shtetas kishin mbyllur aktivitetin me firmen “Arbi 06”, i jane prezantuar me emer te ri firme, “Beti 2008” ,ku i kane kerkuar te merrnin perseri mall,(patatina) por ai ‘ ju ka kerkuar leket qe ata i detyroheshin” dhe nga keta te fundit i eshte thene duke pretenduar se “ nuk kemi leke per momentin, por do te fillonin perseri pune dhe do te likuidonin. Shtetasi T.K sqaron se perseri ka patur probleme per likudimin nga ana e shtetasve A.Ç dhe K.Ç (pasi ata per cdo rruge qe merrni mall, paguanin nje maune me pak) dhe per kete arsayeje perseri ata i detyrohen edhe per firmen “Bet 2008” te pa paguara, ne shumen e 75564 euro. Po ashtu ky shtetas sqaron se ai i ka kerkuar leket ketyre shtetasve nga vitit 2008, por nuk ja kane kthyer duke e mashtruar dhe duke ngritur pretendime duke thene ‘per nje lokal te tyre qe ndodhje ne Golem, se do ta shesim, dhe do te likuidojme te gjithë leket qe kishin ne shumen 108780 euro, dhe me pas kane vazhduar ta mashtrojne duke i thene “dyqani nuk shitet pasi kishin marre kredi ne banke dhe eshte bllokuar nga banka, por do te shisnin nje shtepi te tyre qe kishin ne Tirane, por leket as ne vitin 2008, as ne vitin 2009 nuk i jane dhene . Po ashtu ky shtetas sqaron se ka biseduar vazhdimisht dhe ne telefon me te dy, si me An ashtu dhe me djalin e tij K. por ata perseri e genjenin duke e mashtruar se do tja lajne borxhin qe i kishin, por leket nga viti 2008, dhe gje ka vazhduar deri ne 2013. Shtetasi T.K sqaron se duke patur bindje te plote, se keta shtetas nuk kane patur dhe nuk kane qellim qe ti japin leket qe i kishin, por e kane mashtruar per vite, dhe ne keto rrethana ne vitin 2013 shtetasi T.K ka bere kallezim penal ne Prokurorine e Tiranës ndaj shtetasit K. dhe A Ç. per mashtrimin e tyre. Shtetasi N.K drejtor i shoqerise “MGJ Robin” ka deklaruar te njejtat fakte, sa më siper. Shtetasi SH.Dka sqaruar se njihet me A.Ç dhe K.Ç pasi ka patur bashkpunim pune, per disa vjet me nje firme transporti dhe bente me mjetet e tij transportin, per interes te mallrave qe keta shtetas do te transportuar nga Maqedonia dhe Bullgaria, vende ku keta shtetas merrin mallin, per ne Shqiperi. Po ashtu ky shtetas sqaron se lidhur me detyrimet reciproke ata kishim marrëveshje mes tyre “ku ai do te bente transportin dhe keta shtetas do te benim pagesen” sipas cmimeve qe ne binim dakort, ku keta shtetas i kane mbetur atij pa likuidur rreth 14 mije euro. Ky shtetas sqaron se nuk eshte mbajtur dokument, por ata jane te regjistruara

tek deklaratat doganore, ku jane targat e mjeteve te tija dhe ku pasqyrohen rruget, dhe mbi kete baze ne vitin 2012 eshte bere rakodimi, ku ka rezultuar kjo diference “detyrimi i pa shlyer”. Të dy shtetasit K. dhe A nuk e kane shlyer ate, duke pretenduar “se do te me lajne ate”, por qe realisht, ky borxh eshte i pa shlyer.

Shtetasja M.M ka deklaruar shtetasit A Ç dhe K.Ç njihet pasi ka patur lidhje shoqerore me ta. Kjo shtetase sqaron se shtetasit A.Ç i ka dhene shumen 22 mije dollareve ky ku i fundit ja ka kerkuar “borxh“, me pretendimin “se do te blinte disa makineri”. Kjo shtetase sqaron se keto leke jane dhene “Kesh”, ne dore dhe jane dhene pa ndonje dokument, por vetem me fjale ‘goje”, ku ne fillim i ka dhene 16 mije dollar dhe me pas dhe 6 mije dollar, por per keto leke te marra borxh, ka dijeni dhe djali tij, shtetasi K.Ç. Po ashtu kjo shtetase sqaron se dhe ne nje rast tjetër i ka dhene perseri shtetasi A.Ç dhe 7600 dollar borxh, por nga keto leke, ky i fundit i ka kthyer vetem 4900 dollar dhe ka pa shlyer dhe 2500 dollar. Po ashtu kjo shtetase sqaron se shtetasi A.Ç ashu dhe djali tij K.Ç i ka thene “kemi falimentuar dhe nuk kemi leke” por duke pretenduar se “do te shesin shtepine e tyre do tja kthej borxhin” ne shumen e 22 mije dollareve qe ka ndaj saj, por realisht nuk ja ka kthyer qe nga nga peridha qe ja ka marre. Shtetasi B.B sqaron se njihet me shtetasit A.Ç dhe K.Ç pasi ka patur mardhenie pune, dhe i ka dhene leke borxh shtetasit A.Çt, kesh ne date 01.07.2009, shumen e 1 milion lekeve te reja, me nje “kontrate noteriale” duke i premtuar se do ta kthente pas 6 muajve. Po ashtu ky shtetas sqaron se shtetasi A.Ç ne vazhdimesi i ka thene se do ti jap, duke pretenduar ‘se do te shiste shtepine” por nuk ia kane dhene “ dhe per kete arsyeje , duke pritur gjate ka arritur ne konkluzioin “:se duke ia shtyre dhe duke i ngritur lloj lloj pretendimesh, dhe shtetasi A.Ç po e mashtron dhe ka qellim qe te mos i kthej leket”.Ne keto rrethana ne vitin 2013, ai i eshte drejtuar Gjykates se Tirane me nje padi. Pyetur me cilesine e personit qe tregon rrethana objekt hetimi, shtetasi A.Ç sqaron se ai “u ka marre hua” shtetasve H. M dhe M.M, por nuk i ka marre shtetasve SH.D,I.K dhe B.B ku ketij te fundit i ka marre por eshte likuiduar) Po ashtu ky shtetas sqaron se per sa i perket shoqerise “Mcrobin Gostivar”,me pronar T.K, nuk i ka marre hua ketyre shtetasve, por jane keta te fundit qe i kane borxh,ne shumen qe eshte deklaruar nga ana tyre. Gjthashtu ky shtetas sqaron se ata punonin me nje aktivitet privat, se bashku me djalin e tij K.Ç merrnin mallra te ndryshme ushqimore dhe per kete arsyeja jane marre nga ana e tyre keto leke hua, por me mirkuptimin e te dy paleve. Po ashtu ky shtetas sqaron se ky aktivitet ishte i rregjistruar ne QKR, ne emerin “ARBI 06”,me e as mbylljes se saj ,firma tjetër me emerin “BETI 2008”, por keto aktivite jane te

mbyllura ne QKR, dhe figurojne te pezulluara qe ne fundi te vitit 2012. Poashtu dhe shtetasi K.Ç ka sqaruar te njejten gje sa sipër. Pra rezulton e provuar se shtetasit K.Ç dhe A.Ç kanë konsumuar me dashje direkte elementët e veprës penale “Mashtrimi” në bashkëpunim më shumë se një herë dhe me pasoja të rënda në dëm të shtetasve F.Y, M.M, B.B, SH.Ddhe T.K parashikuar nga neni 143/2 të K.Penal. Për këto fakte që u atribuohen shtetasit K. dhe A C. janë marrë në cilësinë e të pandehurit për veprën penale sipas nenit 143/2 të Kodit Penal. Duke patur parasysh natyrën dhe rrezikshmërinë e veprës penale që u atribuohet del domosdoshmëria për caktimin ndaj tyre saj të masës së sigurimit pasuror. Për sa i përket caktimit të masës së sigurimit shtrënguese, ekzistojnë kushtet dhe kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 228, 229, dhe 274 të Kodit të Procedurës Penale. Duke marrë në konsideratë kushtet dhe kriteret për caktimin e masave të sigurimit personal, shkallën e lartë të përhapjes së veprave në fjalë, masën e dënimit të parashikuar nga ligjvënësi si dhe rrezikshmërinë e të pandehurit K. C. ndaj të cilit ekzistojnë dyshime të arsyeshme të bazuara në prova se ka kryer veprat penale që i atribuohen, arrihet në përfundimin se, masa e sigurimit shtrënguese “Sekuestro preventive” e parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale është më të përshtatshme në raport me masat e tjera të sigurimit personal të parashikuar në ligjin procedural penal dhe vlerësohet se nevojat e sigurimit të procedimit penal nr. 5305, të vitit 2013 do të garantoheshin me këto masa sigurimi. Kjo masë kërkohet pasi ka rrezik që disoponi i lirë i sendeve nga ana e shtetasit K.Ç mund të rëndojë, zgjasë ose edhe lehtësojë kryerjen e veprave penale të tjera nga i pandehuri. Nga verifikimi pranë ZRPP Vendore Tiranë rezulton se, në emër të shtetasit K.Ç janë të regjistruara pasuri të paluajtshme dhe pa barrë siguruese si më poshtë vijon:

Zona kadastrale nr. (.....)volumi 46:

1. Pasuri Nr. (.....), faqe 25 „Apartament me sip. 53.4m², rr. (.....)
2. Pasuri Nr. (.....), faqe 26 „Apartament me sip. 107.5m², rr. (.....)
3. Pasuri Nr. (.....), faqe 27 „Apartament me sip. 150.7m², rr. (.....)
4. Pasuri Nr. (.....)faqe 28 „Apartament me sip. 150.7m², rr. (.....)

Duke patur parasysh gjendjen financiare të të pandehurit K. C., vendosja e sekuestros preventive ndaj pasurive të paluajtshme të detajuara si më sipër, në pronësi të ti, konsiderohet e domosdoshme me qëllim mos rëndimin e pasojave të veprës penale dhe ndalimin e kryerjes së veprave të tjera. Për këto arsye, kërkohet që të caktohet edhe masa e sigurimit pasuror “Sekuestro preventive” e parashikuar nga neni 274 i K.Pr.Penale për pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të personit nën hetim K.Ç, me referencat e mësipërme”.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga ana e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Tiranë, analizoi provat shkresore të paraqitura nga ana e këtij subjekti, në interpretim të kuadrit ligjor procedural penal që disiplinon masat e sigurimit pasuror në procedimin penal, vlerëson se kërkesa është e mbështetur në prova e ligj dhe si e tillë duhet pranuar. Gjykata duke iu referuar rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën po heton organi i Prokurorisë, rrezikut që nga ana e personit nën hetim K.Ç pasuritë e lartpërmendura mund të disponohen tek të tretët, çka do të komplikonte e vështirësonte hetimin e mëtejshëm nga ana e organit të Prokurorisë, çmon të disponojë me pranimin e kërkesës për marrjen e masës së sigurimit pasuror të Sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të cituara si më lart.

PËR KËTO ARSYE

**Gjykata, bazuar në nenet 36 të Kodit Penal, 274 e 276 të
K.Pr.Penale**

V E N D O S I

5. Pranimin e kërkesës.
6. Caktimin e masës së Sigurimit Pasuror “**SEKUESTRO PREVENTIVE**” mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara në ZVRPP Tiranë, në emër të shtetasit K.Ç, të ndodhura në Tiranë, Zona Kadastrale Nr. (.....), Volumi 46, si vijon:
 - **Pasuria Nr. (.....), faqe 25, Apartament me sip. 53.4 m², Rruga “(.....)”**
 - **Pasuria Nr. (.....)faqe 26, Apartament me sip. 107.5 m², Rruga “(.....)”;**
 - **Pasuria Nr. (.....), faqe 27, Apartament me sip. 150.7 m², (.....)”;**
 - **Pasuria Nr. (.....), faqe 28, Apartament me sip. 150.7 m², Rruga (.....)**
11. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit.
 - **U shpall sot, në Tiranë, më dt. 27.05.2014.**

SEKRETARE
Beglie NURA

GJYQTAR
ARDIAN KALIA

